



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr.21

Prishtinë, më 21.5.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Fidan Rekaliu, Nezir Çoçaj, Abdyl Salihu, Adem Mikullovc, Arbërie Nagavci, Verica Çeraniq, Mufera Shinik dhe Albulena Balaj – Halimaj.

Mungoi: Valentina Bunjaku – Rexhepi.

Përfaqësues të tjerë: përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Shaip Goxhuli dhe Rudinë Fetahaj, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të datës 4.5.2018, 8.5.2018 dhe 11.5.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të datës 4.5.2018, 8.5.2018 dhe 11.5.2018

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më datë 8.5.2018 dhe 11.5.2018, u miratuan pa vërejtje. Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më datë 4.5.2018, u miratua me vërejtjen e deputetes Verica Çeraniq, për plotësimin e diskutimit të saj.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Ismajl Kurteshi, tha se vonesa në procedimin e propozimit për përcaktimin e sanksioneve nga ana e përfaqësuesve të MASHT, flet për papërgjegjshmëri nga ana e tyre dhe zvarritje në miratimin e këtij ligji. Në vazhdim, kërkoi nga anëtarët e komisionit të përcaktohen për mënyrën e shqyrtimit të projektligjit.

Nezir Çoçaj, propozoi që shqyrtimi i këtij projektligji të bëhet nen për nen, në mënyrë që të mos bëhet asnjë lëshim i mundshëm.

Mufera Shinik, propozoi që në nenin 3, nënparagrafi 1.14 i projektligjit, tek inspektimi, mbikëqyrja dhe monitorimi në cilësinë e arsimit, në të gjitha nivelet, të shtohet edhe fjalia: “në gjuhët e të cilave zhvillohet arsimimi në Kosovë”, duke u arsyetuar që nëse inspektori nuk e njeh gjuhën, atëherë ai nuk mund ta kuptojë mënyrën e funksionimit të arsimit.

Teuta Haxhiu, tha se vendosja e një fjalie të tillë në ligj, nuk e ka vendin në këtë nen, por edhe si e tillë nuk do të paraqiste ndonjë problem.

Ismajl Kurteshi, tha se sa i përket propozimit të Mufera Shinik, nuk e konsideron të nevojshme përfshirjen e asaj fjalie në këtë nen, për shkak se kjo çështje është e rregulluar me anë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Nezir Çoçaj, mbështeti deputeten Haxhiu dhe tha se shtimi i kësaj fjalie, nuk do të pengonte asgjë zbatimin e këtij ligji.

Pas diskutimeve, anëtarët e komisionit, me shumicë votash përkrahen propozimin e deputetes Mufera Shinik, që të vendoset që në nenin 3, nënparagrafi 1.14. të shtohet teksti: “në gjuhët e të cilave zhvillohet arsimimi në Kosovë”.

Anëtarët e komisionit vazhduan me shqyrtimin nen për nen të projektligjit.

4. Të ndryshme

Kryetari i komisionit propozoi që më datë 22.5.2018, të mbahet takim i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë.

Gjithashtu, tha se komisioni gjatë muajit qershor 2018, do të organizojë një debat parlamentar, lidhur me gjendjen e arsimit në Kosovë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,
Ismajl Kurteshi